



E DASHUR FAMILJE!

Kompetenca gjuhësore është çelësi për botën. Së bashku me Ju si familje duam t'i dëgjojmë fëmijët me vëmendje, të jemi në një bashkëbisedim me ta dhe t'i shoqërojmë në zhvillimin e tyre gjuhësor.

Në Vjenë flasim shumë gjuhë. Më rëndësi është që të gjitha gjuhët e familjeve të fëmijëve të vlerësohen. Në kopshtin e fëmijëve fëmija Juaj përkrahët nëpërmjet veprimtarive të ndryshme në zhvillimin gjuhësor në gjuhën gjermane. Edhe Ju mund ta përkrahni fëmijën Tuaj: Flisni dhe luani me fëmijën Tuaj në shtëpi në gjuhën e familjes Suaj. Kështu do t'ia jepni një bazë të mirë për mësimin e gjuhëve të tjera.

PËRKRAHJA E FËMIJËVE NË FAMILJE DHE NË KOPSHTIN E FËMIJËVE – SI JEPET?



PËRKRAHJA GJUHËSORE NË KOPSHTIN E FËMIJËVE

Në jetën e përditshme të kopshtit të fëmijëve edukatorët dhe edukatorët ofrojnë në mënyrë të qëllimtë një përkrahje gjuhësore. Ata i përkrahin fëmijët duke luajtur, me këngë, tregime dhe oferta për të lëvizur si edhe duke ndërtuar, sajuar dhe eksperimentuar. Më rëndësi është që fëmijët të marrin pjesë me gëzim dhe me kureshtje.

Një shembull nga jeta e përditshme në kopshtin e fëmijëve: Paulës i mungojnë shpesh fjalë – edukatorja vështron me të një libër me ilustrime mbi macet. Këto i ka jashtë mase qejf Paula. Fëmijë të tjerë bashkohen nga kureshtja. Së bashku zbulojnë në bisedë aventurat e historisë. Në vazhdim zhvillojnë një lojë me lëvizje „Kafshët e egra“. Tarek ndien ende vështirësi në formimin e fjalive. Atij i pëlqen të këndojë. Për këtë arsye edukatorja zgjedh këngë gazmore me shumë përsëritje.

VËZHIMI I STATUSIT GJUHËSOR NË KOPSHTIN E FËMIJËVE

Dy vjet para fillimit të shkollës edukatorët dhe edukatorët vëzhgojnë gjatë jetës së përditshme në kopshtin e fëmijëve zhvillimin gjuhësor të fëmijëve në situata të ndryshme lojërash dhe bisedash. Rezultatet e këtyre vëzhgimeve tregojnë nëse fëmija Juaj ka nevojë për një përkrahje shtesë. Kështu fëmija Juaj mund të përkrahët herët në mënyrë të qëllimtë.

NGA KOPSHTI I FËMIJËVE PËR NË SHKOLLË

Gjuha mësimore në shkollë është gjermanishtja. Nëse fëmija Juaj kupton dhe flet gjuhën gjermane, ai mund të marrë pjesë në mësim në mënyrë aktive. Nëpërmjet kësaj përjeton suksese dhe rrit besimin në vetvete. Për pjesëmarrjen në një bisedë në grup dhe për lidhjen e miqësive është gjithashtu me rëndësi që fëmijët të kuptojnë njëri-tjetrin.

PRANDAJ PËRKRAHJA GJUHËSORE NË KOPSHTIN E FËMIJËVE ËSHTË NJË SHANS



REGJISTRIMI NË SHKOLLË DHE FLETA E DORËZIMIT

Në vitin e fundit të kopshtit të fëmijëve bëhet në pranverë regjistrimi në shkollën fillore. Në këtë rast drejtorja e shkollës verifikon pjekurinë për shkollën dhe njohuritë e gjuhës gjermane. Në ditën e fundit të kopshtit të fëmijëve Ju si familje merrni një fletë dorëzimi. Në këtë fletë përshkruhet statusi gjuhësor aktual i fëmijës Suaj. Në javën e parë të shkollës duhet t'ia dorëzoni këtë fletë mësueses ose mësuesit të fëmijës Suaj. Në këtë mënyrë fëmija Juaj mund të përkrahët me vazhdimësi nga pedagoget dhe pedagogët e kopshtit të fëmijëve dhe të shkollës.

GËZOHEMI QË SË BASHKU ME JU SI FAMILJE DO TA SHOQËROJMË FËMIJËN TUAJ NË KËTË RRUGË!